



Diskriminimi i shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tij

(Legjislacioni, praktika dhe roli i organizatave jofitimprurëse)

Tiranë, 2016

Titulli i studimit: “Diskriminimi i shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tij.” (Legjislacioni, praktika dhe roli i organizatave jofitimprurëse)

Ky raport u hartua me mbështetjen e Civil Rights Defenders, me fonde të qeverisë suedeze përmes programit “Rritja e qasjes në liri dhe drejtësi në Shqipëri”.

Falenderojmë Civil Rights Defenders dhe Qeverinë e Suedisë për gjithë mbështetjen financiare dhe teknike në kuadër të zbatimit të këtij projekti.

Përgatiti: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi (Akademike e asociuar).

Av. Aurela Bozo & Av. Iris Aliaj, bashkautore në Kreun V.

Çështjet janë përfaqësuar dhe monitoruar nga: Av. Ledia Muraku, Av. Aurela Anastasi, Av. Besa Saraçi, Av. Aurela Bozo, Av. Iris Aliaj

©Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Tiranë, 2016

Përmbajtja e Lëndës

Lista e Shkurtimeve	4
Hyrje	5
1. Metodologjia për kryerjen e studimit	7
1.1 Kërkimi, studimi i përvojave dhe mbledhja e të dhënave empirike	7
1.2 Metoda ndëraktive e pjesëmarrjes së grupeve të interesit	8
2. Kuptimi i diskriminimit të shumëfishtë, shkaqet dhe pasojat e tij	10
3. Ligji dhe diskriminimi i shumëfishtë	13
4. Diskriminimi i shumëfishtë dhe jurisprudenca gjyqësore	17
5. Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë në praktikën e institucioneve në Shqipëri	19
5.1. Shqyrtimi i diskriminimit për më shumë se një shkak, nga Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi.	19
5.2 Roli i organizatave të shoqërisë civile në identifikimin dhe denoncimin e diskriminimit të shumëfishtë.	22
6. Konkluzione dhe sugjerime	27
Bibliografia	29
Aneks	31
Aneks 1	31
Aneks 2	32
Aneks 3	40

Lista e Shkurtimeve

BE-Bashkimi Evropian

CEDAW-Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

CRCA- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri;

CRD-Civil Rights Defenders

DAR-Drejtoria Arsimore Rajonale

ERRC- Qendra Evropiane për të Drejtat Rome;

GJED - Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJEDNJ- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNJ -Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut

KMD-Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi

KShH-Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Kushtetuta e RSH-së-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

LRER-Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

MRRS-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

OJF- Organizata Jofitimprurëse

QNL-Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

SHSSH-Shërbimi Social Shtetëror

TLAS- Shërbimi Ligjor Falas

Hyrje

“Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” (më tej QNL) paraqet këtë raport për të trajtuar diskriminimin e shumëfishtë në kuadër të veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse për mbrojtjen nga diskriminimi. Në praktikën tonë për ndjekjen dhe përfaqësimin e rasteve për mbrojtjen nga diskriminimi në pesë vitet e fundit (2011-2016), kemi vënë re shpesh se, diskriminimi për shkak të gjinisë shoqërohet edhe me diskriminimin për shkaqe të tjera. Ky fakt, ka pasoja më të rënda ndaj subjektit që diskriminohet, prandaj kërkon një trajtim të veçantë nga ligji dhe nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi. Ndërkohë, asnjë nga ligjet e posaçme për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri nuk parashikon rregullime në lidhje me të. Në praktikën e deritanishme të institucioneve përgjegjëse, ai është trajtuar vetëm spontanisht dhe nuk ka një adresim të qartë të pasojave që sjell ose të sanksionit që duhet të jepet për të, në raport me diskriminimin për një shkak të vetëm. Prandaj, ky raport ka për qëllim të sjellë në vëmendje, nevojën për një kuptim të drejtë të diskriminimit të shumëfishtë, për identifikimin, adresimin dhe gjykimin e tij, në mënyrë që të rritet efektiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes prej tij.

Raporti është hartuar duke analizuar kryesisht, përvojat e rasteve të ndjekura përpara Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi nga QNL, për periudhën 2011-2016. Kjo periudhë përkon me hyrjen në fuqi “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹, si dhe me zbatimin e ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008).

Kur filluam punën tonë për zbatimin e legjislationit të ri kundër diskriminimit nuk e kishim njohur konceptin e diskriminimit të shumëfishtë, i cili nuk ishte trajtuar apo përkufizuar nga ligjet në këtë fushë. Por, në praktikë konstatojmë se në mjaft raste diskriminimi kryhej për disa shkaqe, të cilat i kemi adresuar përpara Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi. Praktika e punës së përditshme na nxiti dhe na ndihmoi t’i kushtonim një vëmendje më të madhe shkaqeve për të cilat kryhej diskriminimi, pasi në diskriminimin për shumë shkaqe, pasojat ndaj personit të diskriminuar janë më të rënda.

Për sa më sipër, ky është një studim i parë për këtë çështje në gjuhën shqipe. Dëshirojmë që ai të përmbushë pritshmërinë e lexuesit për të pasur njohuritë bazë

¹ Ligji nr. 10221, Dt. 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

për diskriminimin e shumëfishtë, si dhe të mënyrës se si ai duhet të adresohet nga organet kompetente dhe gjykatat. Duke bërë një analizë modeste të trajtimit të tij nga institucionet shqiptare që punojnë për mbrojtjen nga diskriminimi, qëllimi ynë është të evidentojmë edhe rolin e grupeve të presionit dhe të organizatave jofitimprurëse për këtë çështje, në mënyrë që ta fuqizojmë atë më tej.

1. Metodologjia për kryerjen e studimit

Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij punimi është një kombinim i metodave cilësore dhe sasiore, kombinim i cili na ka ndihmuar ta studiojmë diskriminimin e shumëfishtë në disa aspekte. Termi “diskriminim i shumëfishtë” do të përdoret për të gjitha rastet kur diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak, pavarësisht nga format e ndryshme me të cilat mund të shfaqet diskriminimi i shumëfishtë. Studimi synon të japë një vështrim të kuptimit të përgjithshëm të këtij fenomeni dhe të identifikojë format, efektet dhe çështjet me të cilat shfaqet diskriminimi i shumëfishtë. Kjo ka qenë e domosdoshme, parë që në bibliografinë e studimeve në gjuhën shqipe mungon një trajtim, qoftë edhe bazik për diskriminimin e shumëfishtë. Kështu, qëllimi ynë i parë mbetet sjellja në vëmendjen e të gjitha institucioneve dhe grupeve të interesit i një kuptimi të saktë të tij, në mënyrë që të përdoret për parandalimin e tij. Për këtë, u përqendruam në identifikimin dhe monitorimin e praktikave më të mira të ndjekura nga Komisionerja kundër diskriminimit, të orientuar veçanërisht në çështjet që Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe organizata të tjera simotra kanë dërguar për shqyrtim. Një ndihmesë të konsiderueshme ka ofruar konsultimi i gjerë me këto organizata, institucionet dhe grupet e interesit, ku ka spikatur pjesëmarrja dhe diskutimi i Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi, për të kuptuar këtë koncept në terrenin praktik shqiptar.

Nga këndvështrimi i metodologjisë spikasin dy metoda të rëndësishme për realizimin e këtij raporti:

së pari, kërkimi dhe studimi i përvojave, duke mbledhur të dhënat empirike;

së dyti, metoda ndëraktive e pjesëmarrjes së grupeve të interesit.

1.1 Kërkimi, studimi i përvojave dhe mbledhja e të dhënave empirike

Kjo metodë na ndihmoi mjaft për të gjetur konceptimet dhe tiparet në lidhje me këtë kategori, si dhe për të studiuar e nxjerrë konkluzionet e nevojshme për adresimin e tij. Në kuptimin e mbledhjes së të dhënave, *studimi i literaturës ekzistuese* kishte për qëllim të evidentonte veprat që trajtonin diskriminimin e shumëfishtë. Një hartë e punimeve në këtë fushë është realizuar vetëm përmes studimit të literaturës

në kuadrin e projekteve përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe të literaturës të vendeve anëtare të BE-së, që kanë zhvilluar eksperiencat në këtë fushë, kryesisht pas vitit 2000 e në vijim. Një përvojë të lexueshme kemi gjetur edhe në shtete të tjera veçanërisht në Kanada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Australi. Në këtë mënyrë, kemi arritur të kryejmë një analizë bazike për diskriminimin e shumëfishtë, kuptimin e tij, si dhe kemi krijuar një bazë të dhënash për të zhvilluar më tej studimin.

Një listë e bibliografisë në të cilën jemi bazuar është vendosur në fund të këtij raporti. Ajo që mund të theksohet është fakti se, deri në këtë periudhë në Shqipëri nuk ka të dhëna statistikore, si dhe mungojnë krejtësisht studimet me këtë objekt.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave ka qenë *studimi i rasteve praktike*. Këtu është mbajtur parasysh jurisprudenca gjyqësore, por ishte e vështirë ta gjenim atë në kuadrin kombëtar, ndërkohë që në këtë këndvështrim është e rrallë edhe në gjykatat ndërkombëtare. Një vëmendje të posaçme i kemi kushtuar studimit të vendimeve të Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për periudhën 2011-2016, si dhe kërkesave të organizatave simotra. Për këtë u përgatit një skedë e monitorimit të rasteve të gjykuara nga Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi. Pasi u renditën të gjitha rastet e ndjekura në periudhën 2011-2016, u kërkuar të evidentohet nëse Komisionerja kishte trajtuar diskriminim për më shumë se një shkak të vetëm, apo jo. U studiuan mjaft vendime për të gjetur nëse ky trajtim nga ana e saj ka qenë i qëllimshëm, apo ka qenë spontan. Ky diferencim ishte i nevojshëm për të parë se sa e ka influencuar vendimmarrjen e Komisioneres ky trajtim. Studimi i rasteve na ka ndihmuar për të arritur në disa konkluzione të rëndësishme për të karakterizuar shkaqet e diskriminimit të shumëfishtë dhe pasojat e tij.

1.2 Metoda ndëraktive e pjesëmarrjes së grupeve të interesit

Metoda ndëraktive e pjesëmarrjes së grupeve të interesit është realizuar përmes tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të OJF-ve që punojnë në fushën e mosdiskriminimit, si dhe të institucioneve që në veprimtarinë e tyre ndjekin çështje që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi. Këto grupe të interesit u selektuan qysh në fillim të zbatimit të projektit, duke mbajtur parasysh edhe përgjegjësitë e tyre në këtë fushë. Kështu, u bë i mundur zgjerimi i hartës gjeografike të organizatave që morën pjesë në këtë diskutim, e cila njohu një diversitet mjaft ndihmues, duke mbajtur parasysh se një ndihmesë e vlefshme u afrua edhe nga pjesëmarrja aktive e organizatave që përfaqësojnë grupet e pakicave. Një rol të dukshëm kanë patur diskutimet me organizatat simotra që ofrojnë ndihmë ligjore në këtë fushë, si dhe kanë kërkuar e përfaqësuar përpara komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi shqyrtimin e rasteve të shkeljes së parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit që ato kanë identifikuar në praktikë. Një ndihmesë të veçantë për të realizuar këtë

veprimtari ka dhënë edhe *Civil Rights Defenders*, një nga organizatat që adreson problemet e mosdiskriminimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Përveç organizatave jofitimprurëse, një selektim i institucioneve publike për të marrë pjesë aktive në këtë debat ndihmoi në ballafaqimin e opinioneve dhe në rritjen e diskutimeve për çështjen e identifikimit dhe të adresimit të diskriminimit të shumëfishtë. Për qëllimin e studimit u identifikuan dhe u ftuan në tryeza për diskutime disa kategori institucionesh si, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi; universitetet; organet e qeverisjes qendrore e vendore², etj.

Diskutimi i problematikave të evidentuara nga QNL dhe pjesëmarrja aktive e organizatave dhe institucioneve të ndryshme ndihmuan mjaft në hartimin e këtij raporti. Përfaqësuesit e universiteteve theksuan nevojën e studimeve në këtë fushë dhe shprehën interesin për përfshirjen e kësaj teme në programet mësimore, veçanërisht në lëndën e të drejtave të Njeriut, të drejtën Kushtetuese dhe atë të Barazisë Gjinore. Ndërsa, Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi u shpreh gjatë këtyre diskutimeve se, “nevojiten përmirësime të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi me qëllim që të adresohet më mirë kjo çështje në rastet e shqyrtuara nga ky institucion”.

2 Shih: Aneksi nr. 1 të këtij raporti: Pjesëmarrësit në tryezat e diskutimeve.

2. Kuptimi i diskriminimit të shumëfishtë, shkaqet dhe pasojat e tij

Koncepti i diskriminimit të shumëfishtë filloi të diskutohet në vitet '80, duke trajtuar përvojat diskriminuese që ndeshnin gratë me ngjyrë, sidomos në SHBA. Ky koncept është ndeshur në forma të ndryshme, por në të gjitha rastet ai u është referuar situatave kur diskriminimi ndodh për më shumë se një shkak të vetëm. Shkolla dhe autorë të ndryshëm e trajtojnë diskriminimin e shumëfishtë në kontekste të ndryshme³. Por, pavarësisht nga formulimet, të gjitha shkollat e mendimit u referohen situatave të veçanta ku individët janë subjekt i diskriminimit për më shumë se një shkak. Gjithashtu, është pranuar termi “diskriminim i shumëfishtë” si një term përgjithësues për të gjitha llojet e diskriminimit që kryhen për më shumë se një shkak, pavarësisht nga mënyra se si shfaqen. Në këtë kuadër teoria dallon tri kategori të diskriminimit të shumëfishtë, ose të diskriminimit për më shumë se një shkak: *diskriminimin e shumëfishtë*, *diskriminimin e përbërë* dhe *diskriminimin ndërsektorial (e ndërthurur)*.

Diskriminim i shumëfishtë (në disa literatura quhet edhe “*diskriminim i shtuar*”) përfshin një situatë në të cilën diskriminimi kryhet për më shumë se një shkak, shkaqe të cilat ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. *Për shembull*: një grua e minoritetit rom, mund të pësojë diskriminimin për shkak të gjinisë në një situatë të caktuar kur asaj i mohohet e drejta për punë, ndërsa në një situatë tjetër, mund të pësojë diskriminim për shkak të origjinës së saj, kur i mohohet e drejta për të marrë shërbime nga një subjekt.

Diskriminimi i përbërë, në ndryshim nga diskriminimi i shumëfishtë, përfaqëson situatën kur një person vuan nga diskriminimi në të njëjtën kohë, për më shumë se një shkak ose kur një shkak i ri i shtohet diskriminimit për një shkak tjetër. Këtu mund të japim një shembull të trajtuar në Mbretërinë e Bashkuar: *Perera Vs. Civil Service Commission, UK case (nr.2)*. Në këtë rast punëdhënësi kishte krijuar një seri kërkesash për marrjen në punë si, mosha, eksperiencia në UK, kombësia, njohja e gjuhës angleze. Mungesa e njërit prej kërkesave nuk e ndalonte punëmarrësin të pranohej në punë, por e bënte më pak të pëlqyeshëm, kurse mungesa e dy prej kriterëve i zbriste fare shanset e Pereres që të përzgjidhej për këtë punë⁴.

3 Shih: Tackling multiple discrimination (Practices, policies and laws), European Commission, 2007, pg. 16-17

4 Po aty, fq. 16

Diskriminimi i ndërthurur (ndërsektorial) përfshin një situatë në të cilën shkaqe të ndryshme veprojnë ose ndërveprojnë në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuara me njeri tjetrin. P.sh., një grua mund të ndihet e diskriminuar në punë, pasi për shkak të gjinisë ajo ka një pagë më të ulët se një burrë që punon ngjashëm, por në të njëjtën kohë ajo mund të anashkalohet nga të gjitha përfitimet e trajnimeve dhe të karrierës, për shkak të shtatzënisë së saj.

Guida për diskriminimin e dyfishtë e hartuar më 2010, nga Lewis në Londër, i kategorizon pak ndryshe llojet e diskriminimit. Sipas saj dallohen tre kategori të diskriminimit të shumëfishtë:

1. Diskriminimi i shumëfishtë i zakonshëm- karakteristika të ndryshme, në raste të ndryshme;
2. Diskriminimi i shumëfishtë i shtuar- karakteristika të ndryshme, i njëjti rast;
3. Diskriminimi ndërsektorial- karakteristika të ndryshme të kombinuara.

Sikurse konstatohet lehtë, kjo ndarje konsideron si diskriminim të shtuar, diskriminimin e përbërë ose të kombinuar. Vetë autori pranon se ka një mospërputhje në përdorimin e terminologjisë për diskriminimin e shumëfishtë⁵.

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme, shkollat teorike kritikojnë qasjen e diskriminimit me një shkak të vetëm dhe e konsiderojnë atë të pamjaftueshëm për të ofruar një mbrojtje të përshtatshme për viktimat e diskriminimit. Ata janë të mendimit se vetë ligji duhet të bëjë një trajtim specifik të këtij rasti, pasi në përgjithësi nuk e trajton mirë këtë qasje⁶. Edhe ligji shqiptar e ka këtë mangësi. Ai nuk e përkufizon një kategori të tillë, megjithatë, praktika e Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri, në mënyrë spontane, na jep shembuj të përshtatshëm për të dalluar diskriminimin e shumëfishtë të shfaqur veçanërisht, si diskriminim i ndërthurur (ndërsektorial) ose si diskriminim të përbërë.

Duke trajtuar diskriminimin e shumëfishtë natyrshëm lind pyetja se *cilat janë shkaqet dhe faktorët që e shkaktojnë* atë dhe a ndryshojnë këto raste nga rasti i diskriminimit për një shkak të vetëm? Nga studimet që kanë rrëmuar mbi këtë aspekt, nuk evidentojmë ndonjë ndryshim thelbësor mbi shkaqet dhe faktorët që e shkaktojnë diskriminimin e shumëfishtë, në raport me ato të diskriminimit në përgjithësi. Faktorët mbeten të njëjtë, ndër të cilët mbizotërojnë *paragjykimet dhe stereotipat* që ekzistojnë në një shoqëri. Një studim i kryer nga *Stonewall* në vitin 2001, tregon se në raport me personat e tjerë, "personat që janë të paragjykuar për shkak të origjinës së tyre etnike janë dyfish të paragjykuar, sikurse edhe qytetarët e tjerë të paragjykuar kur i përkasin grupit të *Lesbian* dhe *Gay*, dhe katër herë të paragjykuar për shkak të aftësisë së kufizuar"⁷.

5 "The experience of discrimination on multiple grounds", September 2011, Maria Hudson Policy Studies Institute, University of Westminster, fq. 3
http://www.acas.org.uk/media/pdf/0/3/0112_Multidiscrim_Hudson-accessible-version-Apr-2012.pdf

6 Tackling multiple discrimination, vep.cit. fq. 17

7 Po aty, fq. 20

Në lidhje me pasojat e diskriminimit të shumëfishtë, duhet thënë se në literaturën ekzistuese është dokumentuar shpesh fakti që diskriminimi ka pasoja të drejtpërdrejta në gjendjen psikologjike të individit. Eksperienca të tilla përkthehen në rritje të simptomave të ankthit dhe të depresionit tek personat që pësojnë diskriminim. Individët ndeshen me mjaft stereotipa dhe paragjykime, të cilat për nga natyra e tyre janë mjaft diskriminuese, për rrjedhojë ata ndihen të përjashtuar nga shoqëria. Kjo është vërtetuar edhe përmes sondazheve dhe studimeve të rasteve që janë kryer³. Këto sondazhe janë kryesisht eksperienca të vendeve të tjera. Ndoshta, është e nevojshme të kryejmë sondazhe të ngjashme edhe në Shqipëri. Por, ne mendojmë se, edhe nëse do të kishim kryer ndonjë sondazh të ngjashëm në Shqipëri, do të kishim përfutur rezultate të krahasueshme.

3. Ligji dhe diskriminimi i shumëfishtë

Legjislacioni mbi diskriminimin e shumëfishtë është ende i mangët, megjithatë, pas viteve 2000 ai ka njohur përhapje në Evropë sidomos, në vendet anëtare të BE-së dhe në vetë të drejtën e BE-së.

Direktiva 2000/43/EC dhe direktiva 2000/78/EC kanë synuar adresimin e diskriminimit të shumëfishtë, kur përcaktohet se “në zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë..., Komuniteti Evropian duhet të synojë eliminimin e pabarazisë dhe të promovojë barazinë midis burrave dhe grave, veçanërisht gratë, kur janë viktimat të diskriminimit të shumëfishtë”. Gjithashtu, deklarata e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 17 Maj 2006, ka mbajtur parasysh parandalimin e diskriminimit të shumëfishtë kur ka theksuar se, “është thelbësore që veprimi në lidhje me racën ose origjinën etnike, fenë ose besimin, aftësinë e kufizuar, moshën orientimin seksual, të mbajë plotësisht parasysh ndryshimet gjinore”. Komisioni Evropian në dokumentin e tij “Strategjia për barazinë midis burrave dhe grave 2010-2020” ka adresuar qartë pasojat e rënduara që sjell diskriminimi i shumëfishtë. “Pasojat rënduese të diskriminimit për dy ose më shumë shkaqe, p.sh., mosha dhe gjinia në rastin e një gruaje të moshuar që kërkon vend pune, ka nevojë të adresohet në zbatimin e legjislacionit përkatës, ashtu sikurse edhe në aktet ligjore që parashikojnë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, sikurse janë referuar në artikullin 19 të TFEU”.


Diskriminimi i shumëfishtë mund të adresohet edhe në zbatim të nenit 14 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut (KEDNJ), sidomos pas hyrjes në fuqi të protokollit 12. Megjithatë, nuk kemi një trajtim të këtij diskriminimi nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Një akt i të drejtës së butë i Asamblesë së Këshillit të Evropës ka njohur drejtpërdrejt diskriminimin e shumëfishtë. Është fjala për Rezolutën 1887 (2012), “*Diskriminimi i shumëfishtë kundër grave myslimane në Evropë: për mundësi të barabarta*”.

Diskriminimi i shumëfishtë ka njohur një vëmendje të veçantë në SHBA, në Kanada dhe në Australi. Megjithatë, edhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, kemi një zhvillim të praktikave administrative e gjyqësore që e adresojnë diskriminimin e shumëfishtë. Në këtë kuadër, janë zgjidhur nga gjykatat ose organet përkatëse raste të diskriminimit të shumëfishtë në Danimarkë, Letoni, Irlandë, Suedi, si dhe në Angli. Këto vende dallohen kryesisht, për përvojat e tyre gjyqësore të trajtimit të

diskriminimit të shumëfishtë. Sidoqoftë, numri i rasteve nga praktikat gjyqësore të të gjitha vendeve mbetet relativisht një numër i kufizuar.

Situata ligjore në vendet anëtare të BE-së është e vakët në raport me një situatë të përgjithshme të sanksionimit me ligj të diskriminimit të shumëfishtë në mënyrë të shprehur. Modele të sanksionimit të këtij diskriminimi shprehimisht në ligj gjetëm vetëm në Austri, Gjermani, Rumani dhe Spanjë. Një përpjekje për ta sanksionuar atë shprehimisht ishte bërë edhe në Angli në vitin 2010, në projekt-aktin për amendimin e *Equal Treatment Act*, dt.14.08.2006, *Section 4*. Porse, përfundoi pa sukses, pasi pikërisht ky seksion nuk u miratua.

Grafiku 1. Shtetet anëtare të BE-së që kanë parashikime në legjislacion për diskriminimin e shumëfishtë.



Në grafikun e mësipërm, duket se të gjitha shtetet kanë dispozita për mbrojtjen nga diskriminimi, por vetëm 4 prej tyre e parashikojnë shprehimisht diskriminimin e shumëfishtë⁹.

Sipas legjislacionit gjerman identifikimi i diskriminimit të shumëfishtë është mjaft i rëndësishëm për të gjykuar mbi sjelljen diskriminuese. Kjo, sepse “Akti për trajtimin e barabartë¹⁰” parashikon: “kur diskriminimi bazohet në më shumë se një shkak,

9 Tabela e krahasimit: Shtetet anëtare të BE-së që kanë parashikime në legjislacion për diskriminimin e shumëfishtë.

Nr.	Shtetet	Lloji i aktit	Parashikimi
1.	Gjermania	Akti për trajtimin e barabartë, 2006, Section 4	Diskriminimi konsiderohet i justifikuar, kur të gjitha shkaqet janë të justifikuara.
2.	Austria	Akti për barazinë e personave me aftësi të kufizuara	Dëmshpërblimi është më i madh kur diskriminimi është i shumëfishtë.
3.	Spanja	Ligji për barazinë midis burrave dhe grave, (Act 340/2006, Article 4h)	Diskriminimi i shumëfishtë mbahet në vëmendje në përgatitjen e studimeve dhe të statistikave.
4.	Rumania	Ligji për barazinë midis burrave dhe grave, (Act 340/2006, Art. 4h). Akti për trajtimin e barabartë (2006)	
5.	Shtete të tjera	Jo parashikime të shprehura për “diskriminimin e shumëfishtë”.	

10 *Equal Treatment Act*, dt.14.08.2006, *Section 4*

mund të jetë i justifikuar, vetëm nëse justifikimi shtrihet në të gjitha shkaqet për të cilat trajtimi është i ndryshëm”.

Në Austri, diskriminimi i shumëfishtë është vendosur në ligj me qëllim vlerësimin e dëmit. Pra, identifikimi i tij është shumë i rëndësishëm për këtë vlerësim, për shkak se pasojat që vijnë prej tij janë zakonisht më të rënda se sa ato që mund të vijnë nga një diskriminim për një shkak të vetëm. Kështu, “Akti për barazinë e personave me aftësi të kufizuara” vendos se, “*autoritetet kanë diskrecionin të mbajnë në vëmendje diskriminimin e shumëfishtë, kur kryhet vlerësimi i dëmit*”.

Legjislacioni në Spanjë kujdeset për mbledhjen e të dhënave statistikore në lidhje me diskriminimin e shumëfishtë. Ai nuk përfshin parashikime specifike se si të veprohet me ankesat për diskriminimin e shumëfishtë, megjithatë ai përfshin detyra për integrimin e barazisë ndërsektoriale. Duket se, ligjvënësi spanjoll e ka parë këtë lloj diskriminimi në këndvështrimin e nevojave për hartimin e politikave parandaluese për diskriminimin. Prandaj, legjislacioni spanjoll sanksionon se, “*Në përgatitjen e studimeve dhe statistikave të krijohen dhe të përfshihen mekanizmat e nevojshëm dhe indikatorët për të treguar variabelt e tjera të mundshme, përsëritja e të cilave krijon situata të diskriminimit të shumëfishtë në sfera të ndryshme të veprimt*”.

Legjislacioni në Rumani bën përkufizimin e diskriminimit të shumëfishtë dhe ekzistencën e tij e konsideron si një rrethanë rënduese gjatë gjykimit të çështjes. Ligji për barazinë midis burrave dhe grave¹¹, përkufizon diskriminimin e shumëfishtë si një “*akt diskriminimi që kryhet për shkak të dy ose më shumë shkaqeve për diskriminim*”. Kurse, “Akti për trajtimin e barabartë” (2006), përfshin rregullimet e diskriminimit për shkaqet: mosha, aftësia e kufizuar, raca dhe origjina etnike, feja dhe besimi, si dhe orientimi seksual. Akti vendos se, *fakti që diskriminimi kryhet për dy ose më shumë shkaqe, do të trajtohet si një “rrethanë rënduese”.*

Në shtetet e tjera anëtare të BE-së, edhe pse nuk ka parashikime ligjore të shprehura, janë krijuar përvoja gjyqësore ose përvoja nga organet e pavarura kompetente që trajtojnë diskriminimin. Zakonisht, ndodh që praktika dhe jurisprudenca ta nxisin legjislacionin për të bërë rregullime ligjore, me qëllim që të rregullohen problematikat e evidentuara nga praktika. Madje, rastet praktike nxisin jo vetëm përmirësimet ligjore, por edhe studimet e kësaj fushe. Duket qartë se në këtë rast presim të krijohet rrethi i zakonshëm i zhvillimit praktikë-teori-praktikë, gjë që ndihmon në forcimin dhe përmirësimin e ligjeve e më tej, të praktikave gjyqësore. Kështu, p.sh., sanksionimi në të gjitha legjislacionet i formave të diskriminimit (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) është një produkt i ofruar nga jurisprudenca e gjykatave. Për këtë, një ndihmesë të madhe kanë dhënë gjykatat ndërkombëtare, veçanërisht Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED). E para është e njohur për interpretimet e saj që sollën përkufizimet e diskriminimit të drejtpërdrejtë formal e substancial, kurse e dyta e spikatur për interpretimin e diskriminimit të tërthortë. Të dyja këto kategori kanë njohur tashmë përkufizimet e tyre në legjislacionet e shumicës së shteteve evropiane. A do të

11 Act 340/2006, Article 4h

ketë të njëjtin zhvillim legjislativ edhe diskriminimi i tërthortë? Në këtë drejtim mendojmë se po ecet më ngadalë. Për sa e studiuam këtë fenomen, mendojmë se kjo 'ngadalësi legjislative' e ka shkakun tek një lloj ngurrimi i gjykatave për ta trajtuar diskriminimin e shumëfishtë, veç të tjerave, edhe si pasojë e vështirësive për të gjetur provat e nevojshme. Në vijim po sjellim shkurtimisht disa pikëpamje për zhvillimin e jurisprudencës gjyqësore për këtë çështje.

4. Diskriminimi i shumëfishtë dhe jurisprudenca gjyqësore

Jurisprudenca në çështjet e diskriminimit është krijuar dhe zhvilluar nga organet e specializuara për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe nga gjykatat.

Krahas subjekteve që e identifikojnë dhe e ankimojnë diskriminimin (sidomos avokatëve), jurisprudenca luan rolin më të rëndësishëm në zhvillimin e fushës. Më lart ne sollëm përvojën legislative mbi diskriminimin e shumëfishtë në katër shtete anëtare të Bashkimit Europian, por kemi theksuar se mjaft kontribuuese ka qenë jurisprudenca që kanë ofruar gjykatat dhe organet kompetente të disa shteteve të tjera si, Kanadasë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës, etj. Kështu p.sh., në Kanada, krahas Komisionit për të drejtat e Njeriut, spikat roli i Gjykatës së Lartë Kanadeze. Komisioni i të drejtave të njeriut të Ontarios ka pasur disa raste pozitive në këtë drejtim¹². Ndërsa Komisioni i Ontarios në Kanada, e ka kritikuar zgjedhjen strategjike të gjykatave për të shmangur nga shqyrtimi shkaqe të tjera të diskriminimit. Gjykata e lartë Kanadeze ka sjellë një kontribut të rëndësishëm në konceptimin e vetë diskriminimit dhe diskriminimit të shumëfishtë në disa raste¹³. Kjo është një qasje, të cilës i janë përafuar me vendimet e tyre edhe gjykata apo institucione të tjera, edhe në Evropë. Në Suedi jurisprudenca për diskriminimin e shumëfishtë ka marrë një zhvillim të dukshëm në fushën e punës. Gjykatat e punës në Suedi janë fokusuar në diskriminimin e shumëfishtë¹⁴. Gjithashtu, janë disa vendime të Gjykatës së Kasacionit në Francë që kanë dhënë kontribute të rëndësishme për interpretimin e diskriminimit në përgjithësi dhe atij të diskriminimit të shumëfishtë në veçanti. Në vendimin e saj no.v 10-20765, 3 Nëntor 2011, kjo gjykatë ka theksuar se edhe “*diskriminimi i tërthortë mund të evidentojë diskriminim të shumëfishtë*”¹⁵, gjë që nuk e ka bërë vetë GJED, e cila e ka identifikuar e para diskriminimin e tërthortë.

Megjithatë, ka ende një shqetësim që është pikasur edhe nga studiuesit se, gjykatat i tremben trajtimit të diskriminimit të shumëfishtë. Për mendimin tonë, kjo buron

12 Tackling multiple discrimination, vep.cit., fq. 21.

13 Po aty, fq. 20.

14 Shih: EVA SCHÖMER, Multiple discrimination A smokescreen over differences, botuar në “RETFÆRD ÅRGANG 35 2012 NR. 3/138 29 Jurist- og Økonomforbundets Forlag”. [https://www.jur.lu.se/WEB.nsf/\(MenuItemByDocId\)/ID25C9F793A5E653AFC1257D8600290301/\\$FILE/Multiple%20discrimination.pdf](https://www.jur.lu.se/WEB.nsf/(MenuItemByDocId)/ID25C9F793A5E653AFC1257D8600290301/$FILE/Multiple%20discrimination.pdf) dhe Sofia Söderberg Multiple and Intersectional Discrimination in Swedish and EU Labour Law. Spring 2011, (tezë e masterit në Universitetin e Lund Suedi), <http://lup.lub.lu.se/lup/download?func=downloadFile&recordId=2206187&fileId=2214425>

15 Shih slides: http://www.era-comm.eu/oldoku/Adiskri/11_Multiple_discrimination/Mercat-Bruns_Challenge%20of%20multiple%20discrimination%20Sept%2029%20ERA_EN.pdf

nga fakti që gjykatat ndërkombëtare, GJED dhe GJEDNJ, nuk janë shprehur ende për këtë diskriminim. Ndryshe nga sa mund të pritej, GJED nuk e ka adresuar këtë problem, veçanërisht kur ka trajtuar çështje të diskriminimit gjinor¹⁶. Kështu p.sh., sa i përket diskriminimit në bazë shtetësie, GJED ka vendosur disa çështje në lidhje me gratë emigrante, si *Allué*,¹⁷ *Spotti*,¹⁸ *Schöning-Kougebetoulou*¹⁹ dhe *Scholz*²⁰. Këto çështje u trajtuan në kuadrin e lëvizjes së lirë të punëtorëve. Diskriminimit të përjetuar nga këto gra, Gjykata nuk u njohu një dimension gjinor. Kjo nuk ndodhi as në çështjet ku femrat kishin ushtruar prostitucion (*Adouiand Cornuaille*²¹ dhe *Jany et al.*), në të cilat dimensionin gjinor ishte më i dukshëm.²² Gjykata njohu se kishte trajtim diskriminues në bazë shtetësie dhe nuk mori në konsideratë këtë parim themelor, në raport me politikën e Shteteve Anëtare për të refuzuar aksesin e femrave që kanë punuar si prostituta²³. Autorët thonë se në këto raste, Gjykata Evropiane e Drejtësisë mund të konsideronte, të paktën në teori, se kufizimi i lëvizjes së lirë të një grupi punëtorësh kryesisht femra, ishte në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore, si parim i përgjithshëm i së drejtës komunitare.

Ndoshta, shmangia nga trajtimi i diskriminimit të shumëfishtë pasqyron edhe strategjinë e procesit gjyqësor të palëve para gjykatave kombëtare. Zakonisht, ato zgjedhin vetë të mbështeten vetëm në njërin nga shkaqet e diskriminimit. Kjo mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme, sidomos për mungesën e provave, ndryshe nuk ka si shpjegohet një mungesë interesi së paku nga ankuesi për të kërkuar të provuarin e formës më të rëndë të diskriminimit. Megjithatë, “*Ngurrimi i gjykatës më të lartë të BE-së për t’u angazhuar me diskriminimin gjinor ndërsektorial tregon nevojën për më shumë reflektim mbi problemin nga një perspektivë e ligjit të BE-së*”²⁴. Mendojmë se, sanksionimi me ligj i diskriminimit të shumëfishtë do ta ndryshonte këtë qëndrim të jurisprudencës gjyqësore.

Shumë autorë nënvizojnë faktin se legjislacioni antidiskriminim që është në fuqi në shumë vende, nuk është i mjaftueshëm për të mbrojtur nevojat e viktimave që pësojnë diskriminim të shumëfishtë. Gjithashtu, teoria e zhvilluar deri tani e pranon se duhet të ketë studime më të thelluara në lidhje me kuptimin e shkaqeve për diskriminimin e shumëfishtë. Teoria ka mjaft fushë për të studiuar në lidhje me këtë çështje. Ka një prirje për të theksuar se zhvillimi teorik në këtë fushë mund të drejtojë krijimin e një hierarkie midis grupeve të ndryshme ndërsektoriale, kur fokusi është drejtuar në shkaqe të veçanta²⁵.

16 Shih: Multiple discrimination in EU law. Opportunities for legal responses to intersectional gender discrimination? European Commission 2009

17 ECJ C-259 et al/91 [1993] ECR I-4309, ECJ 33/88 [1989] ECR 1591.

18 ECJ C-272/92 [1993] ECR I-5202

19 ECJ C-15/96 [1998] ECR I-47

20 ECJ C-419/92 [1994] ECR I-505

21 ECJ 115/81 dhe 116/81 [1982] ECR 1665

22 ECJ C-268/99 [2001] ECR I-8615

23 Multiple discrimination in EU law..., vep.cit.

24 Multiple discrimination in EU law, vep.cit.

25 Multiple discrimination in EU law, vep.cit.,

5. Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë në praktikën e institucioneve në Shqipëri

V.1. Shqyrtimi i diskriminimit për më shumë se një shkak, nga Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi.

Duke analizuar situatën ligjore për diskriminimin e shumëfishtë në Shqipëri konstatuam se, diskriminimi i shumëfishtë nuk është përmendur në asnjë nga ligjet e posaçme që rregullojnë fushën e mosdiskriminimit. Kjo ka qenë arsyeja që deri më sot nuk mund të evidentojmë ndonjë praktikë institucionale ose ndonjë jurisprudencë gjyqësore që t'i dedikohet në mënyrë të posaçme kësaj kategorie. Megjithatë, janë trajtuar disa raste nga Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi, në të cilat diskriminimi për më shumë se një shkak shqyrtohet në mënyrë spontane. Nga monitorimi i këtyre vendimeve rezulton se, edhe pse Komisionerja nuk është shprehur drejtpërdrejt për ndonjë nga format e diskriminimit të shumëfishtë, ajo ka argumentuar se diskriminimi është kryer për më shumë se një shkak. Nga analiza e përmbajtjes së këtyre vendimeve, mund t'i klasifikojmë këto diskriminime kryesisht si diskriminime ndërsektoriale, por ka edhe raste ku ndeshim diskriminimin e përbërë²⁶.

Rasti 1

Në vendimin nr. 11/2012, rezulton se nga kërkuesja është pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë, si dhe viktimizim për shkak të denoncimit që kërkuesja u ka bërë drejtuesve të institucionit për veprimtari korruptive. Ky pretendim është pranuar plotësisht nga Komisionerja, e cila në vendimin e saj ka konstatuar ekzistencën e diskriminimit për shkak të gjinisë, si dhe të viktimizimit për shkak të denoncimeve të kryera.

26 Shih: "Përmbledhje e vendimeve të komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi", Tiranë, 2014.

Në rastin e mësipërm mund të flasim për një *diskriminim të përbërë*, ku i njëjti subjekt ka kryer diskriminim për shkak të gjinisë e në të njëjtën kohë edhe viktimizim për shkak të denoncimit²⁷, sipas nenit 3, pika 8 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”²⁸.

Nga monitorimi i vendimeve vëmë re gjithashtu, se në disa raste, Komisionerja ka ndjekur një metodë gjithëpërfshirëse, duke numërtuar të gjitha shkaqet e diskriminimit kur këto shkaqe janë të lidhura në mënyrë të natyrshme me njëra-tjetrën. Kjo tendencë duket qartë edhe në rastet kur komisionerja ka filluar çështjet *ex officio*, të cilat i kanë dhënë mundësi Komisioneres për të rrëmuar në të gjitha drejtimet e identifikimit të diskriminimit dhe evidentimit të gjitha shkaqeve për të cilat ai është kryer.

Rasti 2

Çështjen “Për monitorimin e shpërndarjes së nxënësve romë në shkollat 9-vjeçare në Tiranë”, Komisionerja e inicioi me prezumimin se mund të kishte ndodhur diskriminim në këtë shkollë për shkak të etnisë, racës e gjuhës. Ajo kishte marrë një informacion sipas të cilit një grup nxënësish të komunitetit rom ishin regjistruar të gjithë së bashku në të njëjtën klasë të parë të shkollës 9 vjeçare Bajram Curri, në Tiranë. Në këtë rast, komisionerja nuk ka argumentuar se përse e ka iniciuar çështjen për të tria shkaqet, por duket qartë se ajo ka prezumuar tre shkaqe të mundshme të lidhura natyrisht me njëra-tjetrën, siç janë etnia, raca dhe gjuha²⁹.

Identifikimi i të gjitha shkaqeve të diskriminimit dhe analizimi i tyre në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të performuar diskriminimin e shumëfishtë, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në bazë të legjislacionit gjerman ky është një detyrim, pasi institucioni nuk mund të vendosë se diskriminimi ka ndodhur për shkaqe të justifikuar, nëse sjellja diskriminuese nuk rezulton e justifikuar për të gjitha shkaqet. Është rasti të zbatohet edhe nga institucionet tona, pasi është një kërkesë e arsyeshme për çdo organ gjyqësor ose *quasi* gjyqësor. Jo vetëm kaq, por analiza e diskriminimit për të gjitha shkaqet ndihmon në evidentimin e arsyeve dhe faktorëve që kanë çuar në diskriminimin e shumëfishtë, gjë që ndihmon në përfitim të një vendimi të plotë dhe efektiv për të ndaluar diskriminimin. Për të ilustruar sa po parashtrijmë këtu, mjaft të analizojmë vendimin e Komisioneres nr. 93, dt. 30.09.2013, “Për trajtimin e ankesës së shtetasës A.Ç, kundër CEZ shpërndarje sh.a., në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore dhe gjendjes civile”. Në këtë rast, analiza e të gjitha shkaqeve është paraqitur qysh në kërkesën drejtuar Komisioneres. Për ta bërë më të qartë analizën e shkaqeve, një përmbledhje e rastit është e nevojshme, prandaj e paraqesim në kutinë më poshtë.

27 Po aty, fq. 7

28 Shih: Ligji nr. 10221, Dt. 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3/8.

29 Po aty, fq. 30

Rasti 3

Kërkuesja A.Ç., pas zgjidhjes së martesës jeton në një apartament me dy vajzat e saj dhe bashkëjetuesin, me të cilin presin edhe një fëmijë, pasi ajo është shtatzënë në muajin e nëntë. Ajo është në proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore me ish-bashkëshortin nga martesa, pjesë e të cilit është edhe apartamenti ku ajo banon. Por, prej 5 vjetësh ajo ka paguar të gjitha detyrimet financiare në bazë të kontratave për furnizimin me energji dhe ujë që janë lidhur midis ndërmarrjeve përkatëse dhe ish-bashkëshortit. Papritur furnizimi me energji dhe ujë ndërpriten pa asnjë njoftim, pasi ish-bashkëshorti kërkoi në mënyrë të njëanshme zgjidhjen e kontratës me këto ndërmarrje. Kërkuesja kërkoi të lidheshin kontratat me atë vetë, pasi dëshmoi se ajo i kishte të gjitha aftësitë pagueuse, por kërkesa e saj u refuzua. Për më tepër, kompania CEZ e shpërndarjes së energjisë i kërkoi vendim gjykate për të lidhur një kontratë në emër të saj.

Për sa më sipër, kërkuesja iu drejtua Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi dhe argumentoi se diskriminimi ishte kryer për shkaqe, si vijon:

- A.** *Diskriminimi për shkak të gjinisë*, pasi ka diskriminim në ofrimin e shërbimeve nga Kompania CEZ ndaj një gruaje në raport me një burrë. Gruaja nuk mund të bëhet titullare e kontratës, edhe pse posedon shtëpinë dhe i ka të gjitha aftësitë pagueuse pasi për t'u bërë e tillë asaj i kërkohet një vendim gjykate. Këtë pretendim Kompania CEZ e bazonte në faktin se kërkuesja ishte në proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore me ish-bashkëshortin.
- B.** *Diskriminimi për shkak të shtatzënisë* u pretendua pasi në mentalitetin shqiptar prezumohet paragjykimi për një grua shtatzënë nga bashkëjetesa me një burrë tjetër nga ish-bashkëshorti me të cilin ishte blerë apartamenti. Ky diskriminim u pretendua edhe në një aspekt tjetër: mosparashikimi i dispozitave që garantojnë masa të veçanta për furnizimin me energji dhe ujë për gratë shtatzëna dhe fëmijët, ndërkohë që ishte detyrë e këtyre organeve dhe veçanërisht e entit rregullator të energjisë për ta bërë këtë.
- C.** *Diskriminimi për shkak të gjendjes martesore* u pretendua pasi u prezumua paragjykimi që ekziston ndaj një gruaje të divorcuar dhe për më tepër, bashkëjetuese fakti.
- D.** *Diskriminimi për shkak të gjendjes civile* u pretendua për faktin se në këtë kuadër ligji ka ende sanksionime që vendosin kryefamiljarin në pozita mbizotëruese dhe se, Kontrata tip e furnizimit me energji dhe ujë parashikon lidhjen e kontratës për furnizim vetëm me kryefamiljarin, pa marrë parasysh shërbimin ndaj anëtarëve të tjerë të familjes.

Për sa më sipër, në vendimin e saj, Komisionerja ka konstatuar diskriminimin në vijim të të gjitha shkaqeve dhe ka dalë me disa rekomandime. Natyrisht, nuk është ndjekur një analizë e ndarë për çdo shkak, pasi ende nuk kemi parasysh dimensionin që ka shqyrtimi i diskriminimit të shumëfishtë, për më tepër ky nuk është i njohur as nga legjislacioni shqiptar. Por, duke analizuar vendimet, rekomandimet dhe masat e marra nga Komisionerja, konstatojmë se trajtimi në kërkesë i të gjitha shkaqeve që kanë shpënë në diskriminim, ka ndihmuar në identifikimin më të saktë

të diskriminimit, të të gjitha subjekteve përgjegjëse për kryerjen e diskriminimit, si dhe për marrjen e masave sa më efektive³⁰.

Pavarësisht se në rastin e mësipërm nuk u bë një klasifikim se, cilit prej formave të diskriminimit të shumëfishtë ai rast i përket, analiza e shkaqeve krijoi mundësinë të evidentohen më qartë të gjitha organet përgjegjëse që kanë sjellë diskriminim, si dhe aktet ligjore që për nga përmbajtja e tyre krijojnë diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Sidoqoftë, duket një rast tipik i diskriminimit ndërsektorial.

Nga disa vendime të monitoruara kemi konstatuar se në pjesën arsyetuese të tyre, Komisionerja nuk është shprehur qartë se, cilin prej shkaqeve të diskriminimit ajo ka gjetur ose ka pranuar. Madje, në rastet kur kërkesa është rrëzuar prej saj, nuk ka një analizë se përse këto shkaqe nuk ekzistojnë³¹. Në këto raste, nuk mund të arrijmë në një konkluzion të qartë nëse ka identifikuar ndonjë prej formave të diskriminimit të shumëfishtë, apo jemi përpara diskriminimit për një shkak të vetëm. Një mangësi e tillë në analizë, mund të sjellë edhe vendime të gabuara, veçanërisht po të mbajmë parasysh legjislacionin gjerman të sipërpërmendur.

5.2 Roli i organizatave të shoqërisë civile në identifikimin dhe denoncimin e diskriminimit të shumëfishtë.

Për qëllimet e këtij studimi morëm në analizë rastet e ndjekura nga Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi mbi bazën e kërkesës ose të informacionit të organizatave jofitimprurëse, veçanërisht të QNL-së.

Bazuar në raportet e Komisioneres të paraqitura çdo vit përpara Kuvendit arritëm të evidentonim numrin e përgjithshëm të çështjeve që Komisionerja ka gjykuar çdo vit mbi këtë bazë, pra, me kërkesën ose mbi bazën e informacionit të organizatave të shoqërisë civile³².

30 Shih: Vendimet Nr. 93 dhe 94, dt. 30.09.2013, të Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi. Konkretisht, në lidhje me këtë çështje, Komisionerja ka vendosur sa vijon:

Së pari ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë nga Kompania CEZ shpërndarje dhe i ka rekomanduar asaj të marrë të gjitha masat për furnizimin me energji elektrike të kërkuarës. (Në lidhje me Ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime, Tiranë, Komisionerja e pushoi çështjen, për shkak se kjo e fundit korrigjoi sjelljen e saj, menjëherë pasi u njoftua për kërkesën).

Së dyti ka konstatuar diskriminimin e tërthortë të kryer nga ana e Entit Rregullator të Energjisë, pasi kontrata e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët familjarë fetishizon rolin e kryefamiljarit, nuk parashikon aksesin e barabartë që duhet të kenë bashkëshortët ose ish-bashkëshortët, si dhe nuk parashikon trajtim të veçantë për gratë shtatzëna dhe fëmijët në përfitimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike. Komisionerja i është drejtuar me rekomandim entit rregullator të energjisë që të rishikojë kontratën tip "Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë". Në mënyrë simetrike Komisionerja ka vendosur edhe për Entin Rregullator të Furnizimit me Ujë


31 Vendim i Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi, nr. 95/2013

32 Shih: Raport i Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi në: <http://www.kmd.al/index.php?fq=brenda&emri=Botime&gj=gj1&kid=142&kidd=80>


Tabela në total 2010-2015

	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Total ne 5 vite (2010-2015)	Në %
Nr. i çështjeve të iniciuara ex-officio	0	1	14	25	8	17	65	9%
Nr. i çështjeve për të cilat janë paraqitur informacione dhe ankesa nga OJF-të	1	1	9	17	6	7	41	6%
Nr. i çështjeve për të cilat janë paraqitur ankesa individuale	3	13	84	149	166	173	588	85%
Nr. i çështjeve gjithsej	4	15	107	191	180	197	694	100%

Numri i çështjeve në total 2010-2015



Grafiku i çështjeve sipas subjektit kërkues



Nga tabela dhe grafiku i mësipërm duket qartë se në përgjithësi, numri i çështjeve të iniciuara nga Komisionerja me kërkesë të organizatave të shoqërisë civile është relativisht i ulët. Ai përfaqëson vetëm (6%) të çështjeve të shqyrtuara, në raport me 85% të kërkesave individuale dhe 9% të çështjeve që janë filluar nga Komisionerja *ex officio* 9%. Madje, shfaqet edhe një tendencë rënieje vitin e fundit. Ky fakt, mendojmë se lidhet me nevojën që kanë ende organizatat e shoqërisë civile për rritjen e kapaciteteve në këtë fushë dhe për të identifikuar më mirë rastet individuale.

Sidoqoftë, tema e këtij studimi është e fokusuar vetëm në rastet e diskriminimit të shumëfishtë. Prandaj, kishim një pamundësi objektive për të analizuar me hollësi të gjitha kontributet që kanë dhënë organizatat e shoqërisë civile vetëm për këtë çështje. Kjo për faktin se, në kërkesat e tyre drejtuar organeve kompetente nuk është adresuar diskriminimi i shumëfishtë si i tillë, për shkak të mosparashikimit në ligj.

Janë shqyrtuar 15 raste nga Komisionerja, me kërkesën e QNL-së në vitet 2011-2016, që ne i njohim me hollësi në të gjithë ecurinë e procedimit të tyre dhe kjo na jep mundësi të identifikojmë më shumë gjetje në këtë drejtim. Disa nga këto çështje janë konsultuar edhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile, gjë që na ka ndihmuar të nxjerrim disa konkluzione dhe mësimet për të vazhduar më tej.

Në aneksin 2 të këtij studimi ndodhet tabela e rasteve të përfaqësuara nga QNL, përpara Komisioneres për mbrojtjen nga diskriminimi, në periudhën 2011-2016. Duke studiuar atë tabelë mund të lexojmë disa aspekte dhe të arrijmë në gjetje, disa prej të cilave po i përmbledhim si vijon:

1. Konstatohet se forma më e shpeshtë me të cilat shfaqet diskriminimi i shumëfishtë në këto raste është diskriminimi ndërsektorial, ku shkaqet veprojnë në të njëjtën kohë dhe janë të pandashme nga njeri-tjetri.
2. Megjithëse ne nuk kemi bërë asnjë renditje hierarkike të shkaqeve ose të bazës mbi të cilën kryhet diskriminimi, ato mund të tipizohen si vijon:
 - në fushën e marrëdhënieve të punës, shkaku kryesor i diskriminimit evidentohet ai i gjinisë, kurse,
 - në fushën e arsimit shkaku kryesor i diskriminimit identifikohet raca.
3. Në fushën e shërbimeve kemi një shpërndarje të shkaqeve kryesisht, për shkak të gjinisë edhe të racës.
4. Nënvizojmë si karakteristike faktin se, diskriminimi për shkak të gjinisë kryhet i shoqëruar sidomos më diskriminimin për shkak të gjendjes ekonomike e sociale, ndërkohë që për shkak të shtatzënisë, ose gjendjes civile apo familjare, shkaku i gjinisë është i lidhur në mënyrë të natyrshme.
5. Edhe diskriminimi për shkak të racës kryhet së bashku me atë për shkak të gjendjes ekonomike e sociale, ndërkohë që për shkak të etnisë ose ngjyrës ai është i shoqërueshëm natyrshëm.
6. Në rastin e diskriminimit të përbërë, shkakut të gjinisë i shtohet veçanërisht, viktimizimi për shkak të ankesave të shprehura.
7. Ngacmimi seksual paraqitet si një nga format me të cilat ushtrohet diskriminimi për shkak të gjinisë.
8. Nga studimi më i thelluar i vendimit konstatojmë se, identifikimi i shkaqeve të ndryshme nuk është shoqëruar me argumente për të provuar ekzistencën e të gjitha shkaqeve. Kjo pasi ato janë trajtuar spontanisht dhe jo qëllimisht, për shkak të mungesës së bazës ligjore.
9. Nuk ka analiza që të konkludojnë mbi faktorët që kombinojnë ose ndërthurin këto shkaqe.
10. Fakti që komisionerja ka evidentuar më shumë se një shkak për diskriminim, ka ndikuar në marrjen e masave për ndalimin e tij. Kjo duket veçanërisht në rekomandimet që ajo jep për çështjen, por nuk është e qartë se si ka ndikuar në vendosjen e dënimit me gjobë.
11. Nga këto çështje rezultojnë të ankimuar në gjykatë vetëm 2 prej tyre. Nuk ka vendime të gjykatave ende, në kohën në të cilën është hartuar ky raport.

6. Konkluzione dhe sugjerime

Së pari, në lidhje me studimin e fenomenit të diskriminimit të shumëfishtë në Shqipëri ka një mungesë të plotë të studimeve dhe të statistikave. Paraqitet nevoja që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë, ajo e Drejtësisë, si dhe Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi të nxisin punën studimore dhe mbledhjen e statistikave në lidhje me diskriminimin e shumëfishtë. Edhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë për mbrojtjen nga diskriminimi janë të mirëpritura në kryerjen e sondazheve, studimeve e monitorimeve në këtë fushë. Nxitja e studimeve shkencore në universitete gjithashtu, është shumë e nevojshme.

Së dyti, në legjislacionin shqiptar ky fenomen nuk është përmendur. Madje, nuk ka ndonjë referencë të këtij diskriminimi as në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Sugjerojmë që në rastin më të parë kur do të ketë një rishikim të këtij ligji ose të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”, diskriminimi i shumëfishtë të adresohet nëpërmjet përkufizimit, si një diskriminim me pasoja më të rënda që duhet mbajtur parasysh në justifikimin e shkaqeve, në vlerësimin e dëmit, si dhe në mbledhjen e statistikave për çështjet e diskriminimit.

Së treti, në lidhje me rolin e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, konkludojmë se diskriminimi i shumëfishtë ka gjetur një adresim spontan dhe ka nevojë të konsolidohet si koncept dhe si një nga format më të rënda të diskriminimit. Për këtë sugjerojmë që të mos pritet ndryshimi i legjislacionit, por të avancohet në krijimin e praktikave të reja ligjore që e sqarojnë më tej këtë koncept dhe e përfshijnë në trajtimin e diskriminimit.

Së katërti, në lidhje me edukimin dhe trajnimin, konstatojmë se ka mungesa në lidhje me këtë kategori dhe mendojmë se ka vend për përfshirjen e temave të tilla në programet mësimore universitare. Studimi i praktikave mbi të duhet të kryhet në arsimin e lartë profesional të avokatëve, gjyqtarëve, prokurorëve, etj.

Së pesti, në lidhje me jurisprudencën gjyqësore, kemi sjellë disa nga përvojat më të mira të gjykatave të vendeve të ndryshme që e kanë zhvilluar diskriminimin e shumëfishtë. Roli i tyre është i rëndësishëm. Në gjykatat shqiptare ende nuk kemi evidentuar ndonjë rast të gjykimit të diskriminimit të shumëfishtë. Çdo trajtim ndërsektorial do të ishte shumë i dobishëm për të adresuar të gjitha nevojat dhe masat që duhet të merren pasi konstatohet diskriminimi për më shumë se një shkak të vetëm.

Së gjashti, në lidhje me rolin e organizatave jofitimprurëse duhet theksuar se këto organizata kanë adresuar për herë të parë çështje të diskriminimit të shumëfishtë, përmes kërkesave të paraqitura përpara Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Por ka nevojë që roli i tyre të fuqizohet në këtë drejtim përmes punës për identifikimin e rasteve, si dhe për rritjen e kapacitetit të avokatëve brenda shoqërisë civile të specializuar për të ankimuar këtë fenomen. Është e nevojshme që organizatat të ngrenë forume me qëllim që të kuptohet diskriminimi i shumëfishtë dhe të zhvillohet diskutimi në lidhje me të. Bashkëpunimi midis organizatave është i nevojshëm edhe për ta ankimuar këtë formë të diskriminimit përpara organeve kompetente dhe në gjykatë.

Së shtati, për avokatin është shumë e rëndësishme të mbajë parasysh se, duhet të identifikohen dhe të argumentohen të gjitha shkaqet nëse ka më tepër se një prej tyre, në kërkesën që i drejtohet organit kompetent për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit; të kërkohet gjatë përfaqësimit përpara gjykatës ose organit kompetent që, ato të merren në analizë një e nga një me qëllim identifikimin e të gjitha problemeve që lidhen me diskriminimin.

Bibliografia

1. "Tackling Multiple Discrimination" Practices, policies and laws. European Commission Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities Unit G.4. Manuscript completed in September 2007
file:///C:/Users/Acer/Downloads/multidis_en.pdf
2. Multiple Discrimination in EU Law Opportunities for legal responses to intersectional gender discrimination? The european network of legal experts in the field of gender equality. Manuscript completed in July 2009.
http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/multiplerediscriminationfinal7september2009_en.pdf
3. "The experience of discrimination on multiple grounds", September 2011, Maria Hudson Policy Studies Institute, University of Westminster
http://www.acas.org.uk/media/pdf/0/3/0112_Multidiscrim_Hudson-accessible-version-Apr-2012.pdf
4. European Union Non-Discrimination Law and Intersectionality: Investigating the triangle of racial gender and disability discrimination. edited by Prof Dr Dagmar Schiek, Professor Anna Lawson
<https://books.google.al/books?id=Jdh7BgAAQBAJ&pg=PT459&lpg=PT459&dq=multiple+discrimination+council+of+europe+Anna+Lawson&source=bl&ots=-l-86i0y3l&sig=t3FYsvjHVs5tjByDpL-EabgVsaHs&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEëi3psHtb3RAhUHVywKHxIvAlkQ6AEIQTAI#v=onepage&q=multiple%20discrimination%20council%20of%20europe%20Anna%20Lawson&f=false>
5. <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=doenloadFile&recordOld=2206187&fileOld=2214425>
6. *Buletin "Drejtësia Gjimore nr.1, mars 2013*, botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, "Dajti 2000", Tiranë 2013.
7. *Diskriminimi në Arsim në këndvështrimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, botim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Dhjetor 2014.
8. *Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë deri në fund të 2014-es*, përgatitur nga The AIRE Centre në

bashkëpunim me zyrën e Agjentit Qeveritar të Shqipërisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Shkurt 2015.

9. *Përmbledhje vendimesh të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian dhe institucioneve të barazisë të rrjetit EQUINET mbi çështje të mbrojtjes nga diskriminimi*, botim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albania, Tiranë 2014.
10. *Përmbledhje e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, botim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albania, Tiranë 2014.
11. *Raport i veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”*, botim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë 2014.
12. *Studim mbi problematikat e diskriminimit të Komunitetit Rom në Shqipëri*, botim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “KRISTALINA.KH”, Dhjetor 2014.
13. *Të drejtat pronësore dhe Gruaja, Broshurë informuese*, botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë 2014.
14. *Të drejtat pronësore të grave, Analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë, Rasti i Shqipërisë*, Arta Mandro-Balili, studim i UN Women Albania, Gent Grafik, Tiranë 2013.
15. *Vërejtje përmblylëse të Komitetit mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave*, botim i Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mbështetur nga UNIFEM pjesë e UN Women, Sesion i dyzetegjashtë 12-30 korrik 2010.

Aneks

Aneks 1

Institucionet dhe organizatat pjesëmarrëse në diskutimet dhe analizat e zhvilluara për diskriminimin e shumëfishtë.

Institucionet:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
2. Avokati i Popullit
3. Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë
4. Fakulteti i Drejtësisë - Universiteti i Tiranës
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universitetit Ismail Qemali, Vlorë
6. Shkolla Kombëtare e Avokatisë
7. Ministria e Mirëqenies sociale dhe e Rinisë

Organizatat jofitimprurëse:

1. Aleanca LGBT
2. Ambasada PINK
3. Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
4. Forumi i Gruas Elbasan
5. Komiteti Shqiptar i Helsinkit
6. Lëvizja Rinore Egjyptiane & Rome
7. Projekti "Fuqizimi Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjyptianët-UNDP
8. Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA
9. Qendra për të Drejtat e Gruas Rome
10. Qendra për zhvillimin e grave rurale - CDRW
11. Rrjeti "Sot për të ardhmen"
12. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri -AWEN
13. Shërbimi Ligjor Falas – TLAS
14. Shoqata "Unë Gruaja Pogradec"
15. Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës
16. Qendra "Të ndryshëm dhe të barabartë"

Aneks 2

Tabela me shkurtime e vendimeve të Komisioneres për Mbrojtjen nga diskriminimi, në lidhje me çështjet e përfaqësuara nga QNL në vitet 2011-2016.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
Nr. 93/2013	Diskriminim në ofrimin e shërbimeve furnizimin me energji elektrike/A.Ç	Gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore, gjendjes civile	Konstatimi i diskriminimit Dpd./ ligji "për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 32/1, a, c dhe neni 33/10	Kompania CEZ shpërndarje sh.a,	Pranimi i kërkesës/ Gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore, gjendjes civile	Rekomandim për furnizimin me energji elektrike të banesës	I pazbatuar
Vijon			Konstatim i diskriminimit të tërthortë/ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 32/1, a, c dhe neni 33/10	Enti rregullator i Energjisë	Nuk shprehet për shkaqet	rishikimi i kontratës tip për furnizimin me energji	
Nr. 94/2013	Diskriminim në ofrimin e shërbimeve furnizimin me ujë.	Gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore, gjendjes civile	Pushimi i gjykimit/ subjekti korrigoj sjelljen me marrjen e kërkesës	Ndërmarrja Ujësjetës kanalizime, Tiranë	Nuk shprehet për shkaqet.		subjekti korrigoj sjelljen me marrjen e kërkesës
Vijon			Konstatim i Diskriminim i tërthortë	Enti rregullator	Nuk shprehet për shkaqet	rishikimi i kontratës tip për furnizimin me ujë	
Nr. 554/2014	Rekomandim Entit rregullator të Energjisë, për rishikimin e kontratës tip mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë.		Rekomandim				

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
Nr. 49/2012	Rekomandim për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal/QNL	Diskriminim i tërthortë për shkak të gjinisë për shkak të gjinisë	Pranimi i kërkesës/Ligji Neni 3/3, 32/1.ë	Ligji	Diskriminim i tërthortë për shkak të gjinisë	Shfuqizimi i nenit 113 të KP	Ekzekutim i pjeshëm. Ndryshimi i nenit 113 të Kodit Penal.
Nr. 12/2012	Konstatim i diskriminimit për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe shqetësimit seksual në punë/ N.Ç.	Gjinisë, gjendjes familjare ose martesore.	Pushim i shyrimit të ankesës./ Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 12,13,15.	Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xh.M	Nuk shprehet për shkaqet	Çështja është pushuar.	I zbatuar. (Vendimi nuk është ankimuar nga N.Ç)
KMD nuk u ka bërë rekomandime institucioneve përgjegjëse.	Informacion se Udhëzimi nr. 991/3, datë 02.03.2010, përbën shkelje të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi"/ QNL.	Gjendjes ekonomike, gjinisë.	KMD nuk u ka bërë rekomandime institucioneve përgjegjëse.	Udhëzim	Nuk ka vendim apo rekomandim në lidhje me këtë çështje.	Nuk është marrë masë për këtë çështje.	
Shkresa Nr.523 Prot./2014	Konstatim i diskriminimit të drejtëpërdrejtë për fëmijët e lindur nga marrëdhëniet jashtë martesore në ofrimin e shërbimeve nga zyra e gjendjes civile./QNL	Gjendjes civile, fëmijë të lindur jashtë marrëdhënieve martesore.	KMD ka konstatuar diskriminim të drejtëpërdrejtë dhe ka bërë rekomandime institucioneve përgjegjëse./ Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 1, 3/9, 20.1 a/b, 32/c;	Zyra e Gjendjes Civile pranë Njësisë bashkake nr. 11.	Diskriminim i drejtëpërdrejtë për shkak të statusit si fëmijë i lindur jashtë martese.	Rekomandim për të gjitha zyrat e gjendjes civile për unifikimin e praktikës për trajtimin e rasteve të fëmijëve të lindur jashtë martese duke shënuar në rubrikën e përbërësve të gjendjes civile "emri i babait", emrin e deklaruar nga nëna,	Zbatuar

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
Shkresa Nr. 306 Prot./2015	Konstatimi i diskriminimit për shkak të gjinisë, të gjendjes familjare e martesore nga zyrrat e gjendjes civile, në ofrimin e shërbimeve mbi bazën e këtyre dispozitave. /QNL	Gjinisë, gjendjes familjare e martesore.	KMD ka konstatuar diskriminim të tërthortë dhe ka bërë rekomandime institucioneve përgjegjëse./ Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 1, 3/2,9, 20.1 a/b, 32.	Ligji	Diskriminim i tërthortë për shkak të gjinisë.	Rishikimin e neneve 16 dhe 17 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", në lidhje me konceptin e "Kryefamiljarit"	I pazbatuar
Nr. 18/2016	Konstatim i diskriminimit të drejtëpërdrejtë për shkak të gjendjes ekonomike dhe shoqërore./ Sh.Q.	Gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore	Konstatimin e mosdiskriminimit/Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi".	Komuna Farkë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	Vendimi i KMD nuk është ankimuar.
Nr.113/2014	Konstatim i diskriminimit për shkak të racës dhe ngjyrës në fushën e të mirave dhe shërbimeve nga Mjekja e Poliklinikës Nr.1, Tiranë, mjeke E.LI dhe mjeke D.D./ M.Ç.	Racës, ngjyrës,etnisë	Konstatimin e mosdiskriminimit./ Nenet 1, 20 pika 2/b e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".	Znj. E.LI dhe znj. D. D mjeke pranë Poliklinikës nr.1, Tiranë.	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	Vendimi i KMD nuk është ankimuar.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
KMD nuk ka marrë vendim për këtë çështje.	Konstatim diskriminimi në lidhje me Urdrin nr. 902. Prot., datë 30.06.2014 të Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik, Bashkia Elbasan, për shtetasin A.K./ QNL, Klinika e Ligjit, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.	Racës, ngjyrës, etnisë, vendbanimit, gjendjes ekonomike.	KMD nuk ka marrë vendim./Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 1, 32 (pika 1.b,c, ë).	Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, Bashkia Elbasan,	KMD nuk ka marrë vendim për këtë çështje.	KMD nuk ka marrë vendim për këtë çështje.	KMD nuk ka marrë vendim për këtë çështje.
Nr.172/2015	Konstatim i diskriminimit të drejtëpërdrejtë për shkak të racës, etnisë në garantimin e shërbimeve./ QNL, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.	Racës, etnisë.	KMD ka vendosur konstatimin e mosdiskriminimit./ Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 1, 3/1,2,9, 20/1, 2 a, ë, 32/1.c,e ë dhe pika 2.	Kompleksi Turistik "Ajek", Elbasan	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	Vendimi i KMD nuk është ankimuar.
Nr.106/2016	Konstatim i diskriminimit për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe shqetësimit seksual në punë./E.K.	Gjinisë, gjendjes ekonomike, gjendjes familjare ose martesore, përgjegjësisë prindërore.	Mospranimi i ankesës./Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 1, 3, 12, 13, 15.	Punëdhënësi, M.A	Nuk shprehet për shkaqet		Vendimi i KMD nuk është ankimuar.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
176/2015	Diskriminim i drejtëpërdrejtë në arsim.	Racës, ngjyrës, etnisë, vendbanimit dhe gjinisë.	Konstatimi i diskriminimit për shkak të racës, në fushën e arsimit. ligji nr.10221/4.2.2010	MAS; DAR Berat	KMD ka konstatuar diskriminim	Marrihen e masave të nevojshme nga ana e MAS dhe DAR Berat, për ndalimin e sigurimit dhe sigurimin e transportit falas, si dhe një përfaqësues të komunitetit, që ti shoqërojnë nxënësit.; Me vendimin nr.17, datë 2.2.2016,	Vendimi i KMD nr.176, datë 16.12.2015 nuk është zbatuar. Me vendimin nr.95, datë 16.9.2016, të Këshillit Bashkiak Berat, Stan-Moravë (shkollë) ishte 2 km, bëhet 2.1 km. Eshhtë miratuar linja e transportit falas, por nxënësit vazhdojnë të mësojnë në shkollën e segreguar.. Vendimi nr.17, datë 2.2.2016 i KMD është ankimuar. Me vendimin nr.485, datë 06.04.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Vlorë është konstatuar pavlefshmëria e aktit administrativ Vendimi nr.17, datë 2.2.2016.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
75/2016	Diskriminim i drejtëpërdrejtë në arsim/F.M.	Racës, ngjyrës, etnisë.	Ndërpërjetjen e procedurave të hetimit. /Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 1; neni 3, pika 1,2,3; nenet 17, 18,19; neni 32, pika c; Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 5, 6, 28, 30 dhe 62.	DAR Elbasan; Shkolla 'Ptoleme Xhuvani"	KMD nuk ka konstatuar diskriminim.	Nxënësi F.M. është kthyer në klasën normale.	Ky vendim nuk është ankimuar.
209/2016	Diskriminim i drejtëpërdrejtë në arsim.	Racës, ngjyrës, etnisë.	Konstatimi i diskriminimit për shkak të racës, në fushën e arsimit. /Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 1; neni 3, pika 1,2,3; nenet 17, 18,19; neni 32, pika c; Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 5, 6, 28, 30 dhe 62.	DAR Elbasan; Shkolla 'Ptoleme Xhuvani"	KMD ka konstatuar diskriminim.	Marrijet e masave të nevojshme nga ana e MAS dhe	Ky vendim nuk është ankimuar deri në datën e përgatitjes së raportit.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
Rek.1194/2016	Diskriminim i tërthortë në shërbime.	Racës, ngjyrës, gjendjes ekonomike sociale.	Janë rekomanduar masa për institucionet përgjegjëse./• Ligji nr.10221, datë 4.2.2010, " Për mbrojtjen nga Diskriminimi", NENI 1, 3,32. • Ligji nr.10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" • Ligji 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe Shërbimet shoqërore", i ndryshuar • Ligji nr.139/2015, „Për vetëqeverisjen vendore”, neni.10, 14, 24.	1. Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër 2. Bashkia Shkodër, e cila e ka në administrim këtë institucion të përkujdesit shoqëror; 3. Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.6 Kombinat, Njësia administrative nr.11 Laprakë, Njësia Bashkiake nr.5, Njësia	KMD ka konstatuar diskriminim.	Marrja e masave nga MMSR, për kontrollin dhe monitorimin periodik të respektimit të standardeve të shërbimeve shoqërore, nga Bashkitë Tiranë, Kamëz, Durrës, Mallakastër, Shkodër për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të	Pritet marrja e masave në zbatim të rekomandimit.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
në proces	Diskriminim i tërthortë në shërbime/N.B.	Racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike sociale, vendbanimit.	Ligji nr.10221, datë 4.2.2010, „ Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, NENI 1, 3,32. Ligji nr.10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”	Administrative Kashar (Yzberish), Bashkia Kamëz, Bashkia Durrës dhe Bashkia Mallakastër (Njësia administrative Ballsh). 4. MMSR 5. SHSSH		komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre, si edhe nga Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër, për rritjen e bashkëpunimit me njësitë vendore, me qëllim që të zbatojnë planin e rugës për të ardhmen dhe kthimin e fëmijës përkohësisht apo përfundimisht në familjen biologjike.	çështja në proces. çështja në proces.

Nr/vendimi	Objekti /subjekti kerkues	Kërkesa/shkaqet	Vendimi/baza ligjore/	Subjekti që ka kryer diskriminimin	Vendimi/shkaqet	Masat	Statusi/ankim/zbatim
në proces	Diskriminim i drejtëpërdrejtë dhe viktimizim në shërbime/E.Z.	Racës, ngjyrës,etnisë, gjendjes ekonomike sociale, vendbanimit.	<ul style="list-style-type: none"> Ligji 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe Shërbimet shoqërore", i ndryshuar Ligji nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni.10, 14, 24. <p>Kushtetuta e RSH-së, neni 18;Ligji nr.10221, date 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 1,3.1; 3.2 ,3.3;8;20;32;33;</p>	Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër; Bashkia Shkodër;	çështja në proces.	çështja në proces.	çështja në proces.

Aneks 3

Pamje nga tryezat e diskutimit.





